

AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE
"K & A" SH.P.K.

Sipas Ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëria Tregtare" dhe Ligjit nr 9723 i 03.05,007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" themelohet sot në datën 20.02.2018, shoqëria "K & A" shpk. Adresa e shoqërisë është: Komuna Bradashesh Autostrada Elbasan-Metalurgji kilometri 2, zona kadastrale 8526, nr pasurisë 105/17, me ortakë Z. Klevis Jaupaj, Bernardo Coku.

VENDOSI:

Krijimin e një shoqërie tregtare me emrin "K & A" shpk. me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Themeluesit, krijojnë shoqërinë tregtare "K & A" shpk, me një statusin ligjor të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në bazë të ligjit nr 9901 të 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me burimet e veta financiare dhe kontributet e paguara në cash.

Neni 2

Kompania gëzon statusin e personit juridik dhe aktivitetet e saj rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi, sipas këtij akt themelimi dhe Statutit e aneksuar.

Neni 3

Kompania do të ushtrojë biznesin e tij nën emrin "K & A" shpk, dhe ky emertim do të shënohet në të gjitha dokumentet, letrat, faturat, etj.

Kompania ka vulën e vet në të cilën është shkruar "K & A" shpk, Elbasan, Shqipëri.

Neni 4

Selia e kompanisë është e vendosur: Komuna Bradashesh, Autostrada Elbasan-Metalurgji kilometri 2, zona kadastrale 8526, nr pasurisë 105/17.

Kompania ka kompetenca të hapë dhe të mbyllë agjencitë e tjera në qytete të tjera të Shqipërisë apo jashtë vendit, nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 5



Periudha e aktivitetit të kompanisë do të jetë i pakufizuar, përveç në rastet kur ortakët vendosin shpërbërjen me të hershme e aktivitetit.

Neni 6

Kompania ushtron veprimtarinë e saj me objekt:

Neni 7

Tregtim shitje me shumice e pakice të mallrave industrial edhe ushqimore, Bar-Kafe-Restorant, import dhe eksportim të mallrave të ndryshëm.

Shoqëria mund të blejë aksione, pjesë kapitali dhe interesa në shoqëri të tjera tregtare. Shoqëria mund të shesë të drejta tregtare, patenta, teknologji dhe të ndërmjetësojë për tregtimin e tyre.

Me vendim të themeluesve, kompania mund të ndryshojë emrin, vendin, statusin ligjor dhe qëllimin e punës, mbasi të deklarojë ndryshimet në këtë akt dhe në statutin e saj.

Neni 8

Kapitali i kompanisë i paguar plotësisht në mjete monetare është caktuar fillimisht nga ortakët në masën 100000 (njëqindmijë) leke.

Kapitali shoqërisë përbehet nga dy kuota të cilat zotërohen nga ortakët si vijon;

- Një kuota me vlerë nominale 51000 leke dhe që përfaqëson 51% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë zotërohet nga ortaku Klevis Jaupaj.
- Një kuota me vlerë nominale 49000 leke dhe që përfaqëson 49% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë zotërohet nga ortaku Benardo Coku.

Neni 9

Kompania zhvillon biznesin e saj për të bërë fitime. Ajo është përgjegjëse për detyrimet që ka ndaj shtetit dhe ndaj personave të tjerë, që nga themelimi i saj.

Neni 10

Kompania kryen aktivitetin e saj administrativ, ekonomik e financiar, në përputhje me legjislacionin aktual dhe me statutin e bashkangjitur.

Drejtimi i shoqërisë do të bëhet nga organet e saj drejtuese, të cilat përbëhen prej administratorit të saj.

Ortakët marrin vendim për emerimin e ekspertit kontabel.

Kompania do të mbajë llogaritë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe do të krijojë një fond rezervë.

Fitimi neto qe do të rezultojë në fund të çdo viti financiar, pas zbritjes së fondit rezervë dhe humbjeve të rezultuara nga vitet e mëparshme, do të shpërndahet ortakeve.

Neni 11

Përcaktimi i strukturës organizative të kompanisë, funksionet, dhe dorëheqja e organeve të tij merren nga organet drejtuese.

Administratori i shoqërisë "K & A" shpk shpk, emërohet zoti Benardo Coku me një afat prej pesë vjetësh.


Administratori duhet të marrë paraprakisht miratimin e asamblesë së ortakeve në formë vendimi të shkruar në lidhje me: Tjetërsimin në çdo lloj forme, duke përfshirë por pa u kufizuar në shitjen, shkëmbimin, dhurimin, përfshirjen në kapitalin themelues dhe çdo lloj forme tjetër tjetërsimi të pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë; Tjetërsimin në çdo lloj forme të asetëve të Shoqërisë që kapin vlerën prej mbi 5% të kapitalit të Shoqërisë; Lidhjen e kontratave me të tretet dhe/ose nënshkrimin e çdo lloj dokumenti tjetër detyrues për Shoqërinë që sjell pasoja financiare që e kalojnë shumën 1000 (njemijë) Euro.

Neni 12

Rregullat për menaxhimin, organizimin dhe prishjen e shoqërisë, janë përcaktuar në statut që është bashkëngjitur në këtë akt themelues.

Ortaket e shoqërisë "K & A" shpk

Klevis Jaupaj



Benardo Coku

